



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

VENDIM

Nr. 139/2019

**PËR SHQYRTIMIN ME PROCEDURË TË PËRSHPEJTUAR TË PROJEKTLIGJIT
“PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 55/2015 “PËR INVESTIMET
STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 83, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 28 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një të pestës së të gjithë numrit të deputetëve,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

I. Të shqyrtojë me procedurë të përshpejtuar projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

II. Shqyrtimi në Komisionin përgjegjës për Ekonominë dhe Financat të bëhet në datat 10 - 13 dhjetor 2019.

III. Shqyrtimi në seancë plenare të bëhet në datën 19 dhjetor 2019.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 5.12.2019